3	CONTINUO DECO	Dy nga dy	Pas të paktën 3 orësh nga faza 2	Mallë inoksi
4	CONTINUO LINK ose LINK ART	Një nga një	Pas të paktën 12 orësh nga faza 3	Rrul
5	CONTINUO TOP ose TOP ART	Një nga dy	Pas të paktën 4 orësh nga faza 4	Rrul
6	CONTINUO TOP ose TOP ART	Dy nga dy	Pas të paktën 3 orësh nga faza 5	Rrul



Sistemi CONTINUO PATIO

Sipërfaqe horizontale betoni, të realizueshme me spesor <3 mm (më pak se 3mm) ose dysHEME betoni CLS.

Faza	Produkti	Shtresa	Kur?	Mjetet
1	EPOXY COMBO + CONTINUO BASE + RRJETE	Një nga dy	Fillim Punimi	Mallë inoksi
2	EPOXY COMBO + CONTINUO BASE	Dy nga dy	Pas 6 orësh nga faza 1	Mallë inoksi
3	CONTINUO DECO	Një nga dy	Pas të paktën 6 orësh nga faza 2	Mallë inoksi
4	CONTINUO DECO	Dy nga dy	Pas të paktën 3 orësh nga faza 3	Mallë inoksi
5	CONTINUO LINK	Një nga një	Pas të paktën 12 orësh nga faza 4	Rrul
6	CONTINUO TOP	Një nga dy	Pas të paktën 4 orësh nga faza 5	Rrul
7	CONTINUO TOP	Dy nga dy	Pas të paktën 3 orësh nga faza 6	Rrul



Sistemi CONTINUO PATIO

Sipërfaqe horizontale me spesor <3 mm (më pak se 3mm) të shtruara me qeramikë, gres të porcelanizuar, monocottura, mozaikë, gurë, të ngjashme.

Faza	Produkti	Shtresa	Kur?	Mjetet
0	Pro-Link	Një	Fillim Punimi	Pinel - Rrul
1	EPOXY COMBO + CONTINUO BASE + RRJETE	Një nga dy	Pas 3 orësh nga faza 0	Mallë - Rrul
2	EPOXY COMBO + CONTINUO BASE	Dy nga dy	Pas 4 orësh nga faza 1	Mallë inoksi
3	CONTINUO DECO	Një nga dy	Pas të paktën 6 orësh nga faza 2	Mallë inoksi
4	CONTINUO DECO	Dy nga dy	Pas të paktën 3 orësh nga faza 3	Mallë inoksi
5	CONTINUO LINK	Një nga një	Pas të paktën 12 orësh nga faza 4	Rrul
6	CONTINUO TOP	Një nga dy	Pas të paktën 6 orësh nga faza 5	Rrul
7	CONTINUO TOP	Dy nga dy	Pas të paktën 3 orësh nga faza 6	Rrul



Sistemi **CONTINUO FURNITURE** dedikuar personalizimit në stile arredimi, objekte dhe aksesore në ambiente private dhe komerciale. **Janë të përjashtuara sipërfaqet e destinuara për përdorim intens profesional (kuzhina – restorante). Mobiljet dhe sipërfaqet, subjekt i presionit mekanik, psh. raftet ose tavolina, duhet të vlerësohen/dimensionohen në mënyrën e duhur, në varësi të presionit që ushtrohet nga përdorimi i dekorimit me sistemin CONTINUO.**

Çdo sistem CONTINUO disponon një skedë teknike me specifikime teknike rreth mënyrës së përdorimit. Për më shumë informacione ose për të kërkuar informacione ose kopje të raportit, kontaktoni shërbimin teknik.

Sistemet CONTINUO nuk janë të përshtatshëm për sipërfaqet në material plastik, konglomerate plastike dhe të ngjashme.



Sistemi CONTINUO FURNITURE
Sipërfaqe horizontale ku nuk ecet, të realizueshme me spesor <3 mm (më pak se 3mm)
Sipërfaqe minerale absorbuese, pllaka betoni të përforcuara e të ngjashme, MDF në spesor të përshtatshëm.

Faza	Produkti	Shtresa	Kur?	Mjetet
1	EPOXY COMBO + CONTINUO BASE + RRJETE	Një nga dy	Fillim Punimi	Mallë inoksi
2	EPOXY COMBO + CONTINUO BASE	Dy nga dy	Pas 6 orësh nga faza 1	Mallë inoksi
3	CONTINUO DECO	Një nga dy	Pas të paktën 6 orësh nga faza 2	Mallë inoksi
4	CONTINUO DECO	Dy nga dy	Pas të paktën 3 orësh nga faza 3	Mallë inoksi
5	CONTINUO LINK- LINK ART	Një nga një	Pas të paktën 12 orësh nga faza 4	Rrul
6	CONTINUO TOP ART	Një nga dy	Pas të paktën 4 orësh nga faza 5	Rrul
7	CONTINUO TOP ART	Dy nga dy	Pas të paktën 3 orësh nga faza 6	Rrul



Sistemi CONTINUO FURNITURE
Sipërfaqe horizontale ku nuk ecet, të realizueshme me spesor <3 mm (më pak se 3mm) të shtruara me qeramikë, mozaikë, gurë, të ngjashme.

Faza	Produkti	Shtresa	Kur?	Mjetet
0	Pro-Link	Një	Fillim punimi	Pinel - Rrul
1	EPOXY COMBO + CONTINUO BASE + RRJETE	Një nga dy	Pas 3 orësh nga faza	Mallë - Rrul
2	EPOXY COMBO + CONTINUO BASE	Dy nga dy	Pas 4 orësh nga faza 1	Mallë inoksi
3	CONTINUO DECO	Një nga dy	Pas të paktën 6 orësh nga faza 2	Mallë inoksi
4	CONTINUO DECO	Dy nga dy	Pas të paktën 3 orësh nga faza 3	Mallë inoksi
5	CONTINUO LINK – LINK ART	Një nga një	Pas të paktën 12 orësh nga faza 4	Rrul
6	CONTINUO TOP ART	Një nga dy	Pas të paktën 6 orësh nga faza 5	Rrul
7	CONTINUO TOP ART	Dy nga dy	Pas të paktën 3 orësh nga faza 6	Rrul

6_ PËRGATITJA, PËRDORIMI I PRODUKTEVE DHE KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

Aplikimi i sistemit CONTINUO do të rezultojë i thjeshtë, performanca finale e sipërfaqeve të dekoruara do të rezultojë konforme dhe që zgjat, thjesht duke respektuar informacionet që përmbahen në fazat operative, hap pas hapi në këtë manual.

Verifikoni paraprakisht përshtatshmërinë dhe gjendjen e mjeteve të punës dhe të dispozitave të sigurisë personale (syze, dorezat, mbrojtëse gjuri etj.).



Në rast se produktet CONTINUO ruhen në temperaturë afërsisht +5°C, këshillohet t'i vendosni, para përdorimit, në një vend me temperaturë të përshtatshme, në mënyrë që të kushtëzohet në një temperaturë përdorimi jo më të ulët se +10°C.



Sipërfaqja e dekoruar dhe e mbrojtur me finiturë transparente do të jetë e kalueshme nga këmbësorët dhe do mund të durojë një trafik të lehtë pas 24 orësh nga aplikimi i shtresës së fundit. Arritja e plotë e rezistencës kimiko-fizike arrihet pas rreth 5 ditësh. Në këtë periudhë kohe mos e rimbulloni sipërfaqen në mënyrë permanente me letra, kartonë për të shmangur dëme estetike të sipërfaqes.

6.1 PRODUKTET CONTINUO

CONTINUO LEVEL_ZERO

- Natyra e lidhësit: Çimento portland, aditivë dhe rezinë sintetike.
- Aspekti: pluhur gri.
- Pesha specifike e niveluesit gati për përdorim: 2,0 c.a. Kg/l
- Koha e punueshmërisë: rreth 30 minuta në 20° C, UR=60%.

Raporti i përzierjes: 25 kg CONTINUO LEVEL_ZERO + 4 - 4.2 l ujë të pastër.

Mos e tejkalonin sasinë e caktuar për të shmangur fenomenet e ndarjes gjatë kohës së vendosjes.

Përgatitja e pastës: hidhni brenda në një kovë të pastër ujin për pastën. Shtoni ngadalë në CONTINUO LEVEL_ZERO ujë, duke e përzier me mikser mekanik spiral.

Koha e përzierjes: normalisht 3 minuta janë të mjaftueshme për përzierjen totale. Pasta e përfutur formon një llaç uniform, tiksotropik dhe pa topa/gunga.

Kohëzgjatja e pastës (pot life): përdoren pastën brenda rreth 30 minutash, më tej kësaj kohe, megjithëse pasta mund të rezultojë e përdorshme, humbet punueshmërinë në aplikim. Përdorni shpatull inoksi për të përhapur pastën dhe rikalonin me shpatull inoksi të dhëmbëzuar.

Është i mundur përdorimi me dhëmbë katrore, ose me dhëmbë V, duke realizuar lëvizjet gjysëmrrreth, duke kërkuar reduktimin e formimit të difekteve të lëna nga niveluesi.

Për të shmangur vënien në dukje të shenjave të shtresave të ndryshme të aplikuara, rekomandojmë shtrirjen e CONTINUO LEVEL_ZERO sa më shpejt të jetë e mundur, për të garantuar shtrirjen maksimale të pastës.

Këshillohet aplikimi duke përdorur një rrul me thumba (frangibolle). Ky operacion ndihmon në reduktimin/eliminimin e ajrit të inkorporuar (fluskave të ajrit) dhe lejon optimizimin e shtresës së aplikuar, duke garantuar uniformitetin estetik sipërfaqësor më të mirë.



Në rast se lind nevoja, mund të aplikohet edhe një shtresë tjetër CONTINUO LEVEL_ZERO. Para aplikimit të një shtrese të dytë të niveluesit CONTINUO LEVEL_ZERO, për të shmangur formimin e mundshëm të çarjeve/kraterëve të vogla në sipërfaqe, aplikoni një shtresë CONTINUO LINK epoksid bi-komponent, të hollueshëm me ujë, transparent, me fuqi të lartë penetruese dhe konsoliduese, për ta përdorur pas hollimit me ujë 200% në peshë.

Mos shtoni më shumë ujë për të zgjatur jetëgjatësinë.

Në rastin e llaçeve me natyrë tjetër, si për shembull ato me bazë sulfat kalciumi CA ose magnezi MA, është mirë të kontaktoni shërbimin teknik.

CONTINUO BASE

- Natyra e lidhësit: çimento dhe rezinë sintetike.
- Pesha specifike e llaçit gati për përdorim: 1,6 c.a. Kg/l
- Aspekti: pluhur i bardhë.
- Dimensioni maksimal i inerteve: 0,75 mm
- Jetëgjatësia: 60 minuta në 20 °C, UR=60%.
- Kohëzgjatja e përzierjes (pot life): Përdoreni përzierjen brenda 60 minutash

Raporti i përzierjes: 25 kg CONTINUO BASE + 5-6 l ujë i pastër

Përgatitja e përzierjes: hidhni brenda një kove/ambalazhi të pastër ujin e përzierjes. Shtoni ngadalë CONTINUO BASE në ujë duke e përzier me mikser mekanik spiral.

Koha e përzierjes: normalisht janë të mjaftueshme tre minuta për përzierjen komplet.

Përzierja e përftuar duhet të japë një llaç uniform, tiksotropik dhe pa topa. Për ta bërë homogjene, mund të bëhet manualisht vetëm për sasi të vogla produkti, maksimumi 5 kg.

Kohëzgjatja e llaçit (pot life): përdoreni llaçin brenda 60 minutash, pas kësaj kohe llaçi megjithëse duket i punueshëm, fillon të humbasë punueshmërinë dhe shtrirjen. Mos shtoni me tepër ujë për të shtuar jetëgjatësinë.

CONTINUO EPOXY COMBO

- Natyra e lidhësit: Rezinë specifike dhe katalit i veçantë
- Solventi: ujë
- Dendësia UNI EN ISO 2811-1:
- Komponenti A=1,08±0,05 kg/l.
- Komponenti B=1,04±0,05 kg/l.
- Kohëzgjatja e përzierjes (pot life): Përdoreni përzierjen brenda 30 minutash

Raporti i përzierjes: 1,6 l Komponenti CONTINUO EPOXY COMBO A + 0,8 l Komponenti CONTINUO EPOXY COMBO B + 3 - 3,5 l ujë + 25 Kg CONTINUO BASE.

Përgatitja e përzierjes: Hidhni brenda një kove të pastër EPOXY COMBO A + EPOXY COMBO B, përziejeni manualisht ose me mikser mekanik spiral me shpejtësi të ulët. Shtoni ujin dhe me mikser mekanik spiral me shpejtësi të moderuar shtoni ngadalë CONTINUO BASE.

Koha e përzierjes: normalisht 3 minuta janë të mjaftueshme për të kompletuar përzierjen. Përzierja e përftuar duhet të japë një llaç uniform, tiksotropik dhe pa topa. Për ta bërë homogjene, mund të bëhet manualisht vetëm për sasi të vogla produkti, maksimumi 5 kg.

Kohëzgjatja e llaçit (pot life): përdoreni llaçin brenda 30 minutash, pas kësaj kohe llaçi megjithëse duket i punueshëm, fillon të humbasë punueshmërinë dhe shtrirjen. Skoçi ose filmat mbrojtës duhet të hiqen në periudhën e parë të forcimit të veshjes epokside të skajshme, pasi pas forcimit të plotë, heqja është jashtëzakonisht e vështirë.



Mos shtoni më shumë ujë për të zgjatur jetëgjatësinë.

Mos tejkaloni sasinë e ujit të sugjeruar për të shmangur anomali gjatë kohës. Në rastin e llaçeve me natyrë tjetër si për shembull ato me bazë sulfat kalciumi CA ose magnezi MA, është mirë të kontaktoni shërbimin teknik.

CONTINUO DECO comp A

- Natyra e lidhësit: kopolimer akrilik në emulsion uJOR.
- Solventi: ujë.
- Dendësia UNI EN ISO 2811-1: 1,77±0,05 kg/l
- Kohëzgjatja e përzierjes (pot life): rreth 120 minuta

CONTINUO DECO comp B

- Natyra e Lidhësit: çimento dhe inerte.
- Aspekti: pluhur i bardhë.

Raporti i përzierjes në peshë: 15 Kg CONTINUO DECO A + 5 Kg CONTINUO DECO B.

Përgatitja e përzierjes: vetëm para aplikimit të produktit në kantier, shtoni, për çdo paketim prej 15 kg CONTINUO DECO A, një paketim prej 5 kg CONTINUO DECO B. Bashkimi i komponentit në pluhur CONTINUO DECO A dhe B duhet të bëhet gradualisht dhe duke e shoqëruar me xhiro te trapanit (duhet të trazohet me trapan). Përzierja e dy komponentëve nuk mund të bëhet manualisht.

Koha e përzierjes: rreth tre minuta. Përzierja e përftuar duhet të japë llaç uniform, tiksotropik dhe pa gunga/topa.

Jetëgjatësia e pastës (pot life): rreth 120 minuta. Pas kësaj kohe, produkti nuk duhet të përdoret.

Hollimi: është i mundur hollimi i përzierjes së përftuar, (15 Kg komponenti A + 5 Kg komponenti B) duke shtuar deri në 5% ujë (1 lt).

Ngjyrosja: Këshillohet homogjenizimi i CONTINUO DECO A para ngjyrosjes. Vazhdoni me ngjyrosjen e CONTINUO DECO A me sistemin tintometrik MARCROMIE. Është e mundur përzierja me mikser xhioskopik ose me trapan me helikë. Këshillohet përfundimi i çdo pune me materiale të të njëjtit fabrikim. Në rast të përdorimit të fabrikimeve të ndryshme, me qëllim shmangien e ndryshimeve të lehta në tonalitet, këshillohet përzierja midis tyre e produkteve të ndryshme. Për punë në të cilat, për arsye madhore, është i domosdoshëm vazhdimi me një fabrikim të ri, mos bëni kombinimin në të njëjtën sipërfaqe. Për rakordimin, përdorni çdo ndërprerje të vazhdimësisë së sipërfaqes si skajet, nyjet e zgjerimit, etj.

Aplikimi: Përdorni malla dhe mjete ÇELIK INOKSI
Para vazhimit të aplikimit të CONTINUO LINK dhe CONTINUO TOP, bëni pastrimin e sipërfaqes duke eliminuar mbetjet e mundshme të pluhurit.

Para aplikimit të astarit, këshillohet lëmimi i sipërfaqes me sandër orbital (levigatore rotorbitale) të pajisur me granë mesatare (120, 150, 180), në varësi të gradës së kompaktësisë së kërkuar. Imazhi 2

Për finitura me aspekt natyral, lisho monolit, është i këshillueshëm lëmimi i sipërfaqeve me furçë të vetme me disk qeleshe (80,120) ose sandër orbital (levigatrice rotorbitale) të pajisur me letër zmerile me granë mesatare (120, 150, 180) në varësi të gradës së kompaktësisë së kërkuar. Imazhi 1.



Imazhi 1



Imazhi 2

CONTINUO LINK

- Natyra e lidhësit: Rezinë epokside dhe katalit specifik
- Solventi: ujë
- Dendësia UNI EN ISO 2811-1:
- Komponenti A=1,08±0,05 kg/l.
- Komponenti B=1,04±0,05 kg/l.
- Dendësia e përzierjes (A+B) UNI EN ISO 2811-1: 1,07 ± 0.02 kg/l
- Jetëgjatësia e përzierjes (Pot-life) (A+B): rreth 60 minuta në 20°

Raporti i përzierjes në peshë: 0,500 l komponent A + 0,250 l komponent B duke shtuar 3 l ujë (shembull në peshë 100 gr komp A + 50 gr komp B) duke shtuar 600 gr ujë.

Përgatitja e përzierjes: Homogjenizoni CONTINUO LINK komponent A nga sedimente të mundshme. Hidhni CONTINUO LINK komponent B në CONTINUO LINK komponent A dhe përziejeni manualisht për rreth 45-60 sekonda

Hollimi: holloni përzierjen e përftuar (0,500 l komponent A + 0,250 l komponent B) duke shtuar 3 l ujë.


Jetëgjatësia e përzierjes: rreth 60 minuta. Më tej kësaj kohe nuk duhet të përdoret, produkti mund të rezultojë ende fluid, por përdorimi mund të komprometojë performancën finale të sistemit.

Aplikimi: Përdorni PINEL,RRUL leshi me gjatësi mesatare.

Përfundoni më parë me pinel perimetrin e dhomës në sipërfaqe ende të lagësht. Aplikoni më pas CONTINUO LINK, duke përdorur një rrul leshi me qime të shkurtra, që të mund të mbulohet e gjithë sipërfaqja.


Në fazën e aplikimit të CONTINUO LINK ART, me qëllim shmangien e formimit të linjave jo estetike, shumë të theksuara që vijnë si pasojë e kalimit të rrulit të leshit, është i këshillueshëm aplikimi i produktit në mënyrë që të mos krijohen vija gjeometrike (lart – poshtë- djathtas – majtas) preferohet realizimi i rrotullimeve jo-homogjene që ndjekin estetikën e spatulimeve, duke integruar në këtë mënyrë estetikën finale të dekorimit (imazhi 1).

I kushtoni vëmendje të veçantë këndeve. Zbatoni detyrimisht kohët e tharjes, para se të vazhdoni me finiturën CONTINUO TOP.



PO

Imazhi 1



JO

Imazhi 2

CONTINUO LINK ART

- Natyra e lidhësit: Rezinë epokside dhe katalit specifik
- Solventi: ujë
- Dendësia UNI EN ISO 2811-1:
- Komponenti A=1,06±0,05 kg/l.
- Komponenti B=1,03±0,05 kg/l.
- Dendësia e përzierjes (A+B) UNI EN ISO 2811-1: 1,05 ± 0.02 kg/l
- Jetëgjatësia e përzierjes (Pot-life) (A+B): rreth 60 minuta në 20°

Raporti i përzierjes në peshë: 0,500 l komponent A + 0,350 l komponent B duke shtuar 2,100 l ujë (shembull në peshë 100 gr komp A + 70 gr komp B) duke shtuar 425 gr ujë.

Përgatitja e përzierjes: homogjenizoni CONTINUO LINK ART komponent A nga sedimentet e mundshme. Hidhni CONTINUO LINK ART komponent B në CONTINUO LINK ART komponent A dhe përziejeni manualisht për rreth 45-60 sekonda.

Hollimi: holloni përzierjen e përftuar (0,500 l komponent A + 0,350 l komponent B) duke shtuar 2,100 l ujë.

Jetëgjatësia e përzierjes: rreth 60 minuta. Më tej kësaj kohe nuk duhet të përdoret, produkti mund të rezultojë ende fluid por përdorimi mund të komprometojë performancën finale të sistemit.



APLIKIMI: Përdorni PINEL, RRUL leshi me qime mesatare. Në aplikimet ku duhet të garantohet performanca maksimale për rezistencën ndaj ujit (shembull kutia e dushit), është mirë, pas hollimit të duhur, aplikimi i CONTINUO LINK ART duke përdorur ekskluzivisht pinelin.

Përfundoni më parë me pinel perimetrin e dhomës. Aplikoni më pas CONTINUO LINK ART duke përdorur një rrul leshi me qime mesatare, duke mbuluar të gjithë sipërfaqen. I kushtoni vëmendje të veçantë këndeve.

Në fazën e aplikimit të CONTINUO LINK ART, me qëllim shmangien e formimit të linjave jo estetike, shumë të theksuara që vijnë si pasojë e kalimit të rrulit të leshit (imazhi 2 shiko faqen para), është i këshillueshëm aplikimi i produktit në mënyrë që të mos krijohen vija gjeometrike (lartë-poshtë- djathtas – majtas), preferohet realizimi i rrotullimeve jo-homogjene që ndjekin estetikën e spatulimeve, duke integruar në këtë mënyrë estetikën finale të dekorimit. (Imazhi 1 shiko faqen para). Zbatoni detyrimisht kohët e tharjes para aplikimit me një nga finiturat CONTINUO TOP ose CONTINUO TOP ART.

CONTINUO TOP

-Natyra e lidhësit: dispersion poliurethani alifatik i modifikuar.

-Solventi: ujë

-Tharja (në 25 °C dhe 65% U.R.): prekja pas 30 min.; shtresa tjetër pas 4 orësh.

-Shkëlqimi UNI EN ISO 2813:

>85, këndi i leximit 60° **TOP GLOSSY**

20 ± 2, këndi i leximit 60° **TOP SATIN**

10 ± 2, këndi i leximit 85° **TOP MATT**

Finiturat CONTINUO TOP komp A janë të formuluarat që të mund të përdoret i njëjti katalit CONTINUO komp B.

Raporti i përzierjes: 2,500 l komponent A + 0,750 l komponent B (10 pjesë komponent A + 3 pjesë komponent B). Përzierja (A+B) e përtuar, përdoret me hollim në peshë – volum 0 – max. 10%).

Hollimi i tepërt i përzierjes dëmton performancën finale të finiturës CONTINUO TOP.

(në volum 10 pjesë komponent A + 3 pjesë komponent B)

(shembull në peshë 100 gr komp A+ 30 gr komp B).

Përgatitja e përzierjes: homogjenizoni manualisht CONTINUO TOP- TOP ART komp. A nga sedimentet e mundshme.

Hidhni CONTINUO TOP komp B në CONTINUO TOP komp A përkatës, përzieni manualisht për rreth 45-60 sekonda. Është e mundur përzierja me trapan me helikë me xhiro të ngadalta për maksimalisht 1 minutë.

Hollimi: holloni përzierjen e përtuar (2,500 l komponent A + 0,750 l komponent B) duke shtuar 0,300-0,400 l ujë.

Jetëgjatësia e përzierjes: rreth 60 minuta. Më tej kësaj kohe produkti nuk duhet përdorur, mos ndërhyjni në rritjen e viskozitetit duke e holluar akoma më shumë me ujë produktin.

Aplikimi: Përdorni PINEL OSE RRUL LESHË me qime mesatare.


Për të përfutur një rezultat optimal, përta i përket homogjenitetit të sipërfaqes dhe uniformitetit të tharjes, shmangni aplikimin nën dritën e drejtpërdrejtë të diellit, në prani të sipërfaqeve të mëdha të xhamit, për të mbrojtur xhamin/dritaret, këshillohet shmangia e rrezeve të drejtpërdrejta të diellit. Përfundoni më parë me pinel perimetrin e dhomës. Aplikoni më pas CONTINUO TOP duke përdorur një rrul leshi me qime mesatare, duke mbuluar të gjithë sipërfaqen.

I kushtoni vëmendje të veçantë këndeve.

Në fazën e aplikimit të CONTINUO TOP, me qëllim shmangien e formimit të linjave jo estetike, shumë të theksuara që vijnë si pasojë e kalimit të rrullit të leshit (imazhi 2) është i këshillueshëm aplikimi i produktit në mënyrë që të mos krijohen vija gjeometrike (lart –poshtë- djathtas – majtas), preferohet realizimi i rrotullimeve jo-homogjene që ndjekin estetikën e spatulimeve, duke integruar në këtë mënyrë estetikën finale të dekorimit.


Mbrojtja finale mund të modulohet në varësi të funksionit dhe estetikës, falë përdorimit të një prej 3 gradëve të shkëlqimit të finiturave. Përdorimi i llaqeve CONTINUO TOP, garanton arritjen maksimale të performancës teknike, pa penalizuar përsosjen estetike të sistemit.

Rezistenca e lartë kimike dhe mekanike, e bëjnë të përshtatshëm për përdorim shtëpiak dhe komercial. Në rastin e finiturave të realizuara me CONTINUO TOP efekt MAT, ku dëshirohet garantimi i rezistencës maksimale ndaj substancave likuide, këshillohet aplikimi i një shtrese CONTINUO TOP SATIN mbi astarin dhe përfundojeni me një shtresë CONTINUO TOP MATT.



PO

Imazhi 1



JO

Imazhi 2

CONTINUO TOP ART

- Natyra e lidhësit: dispersion poliurethan alifatik i modifikuar.
- Solventi: ujë
- Shkëlqimi UNI EN ISO 2813:
 - 20 ± 2, këndi i leximit 60° **TOP SATIN**
 - 4 ± 2, këndi i leximit 85° **TOP MATT**

TOP ART SATIN Komp A: Psp 1.05

Përgatitja e përzierjes: 2,500 l komponent A + 0,750 l komponent B (në volum 10 pjesë komponent A + 3 pjesë komponent B)
(shembull në peshë 100 gr komp A+ 30 gr komp B)

Përzierja (A+B) e përftuar, përdoret me hollim në peshë – volum 0-max 15%). Hollimi i tepërt i përzierjes dëmton performancën finale të finiturës CONTINUO TOP ART.

TOP ART MATT Komp A: Psp 1.20

Përgatitja e përzierjes: 2,500 l komponent A + 0,750 l komponent B (në volum 10 pjesë komponent A + 3 pjesë komponent B)

(shembull në peshë 120 gr komp A+ 30 gr komp B.

Përzierja (A+B) e përftuar, përdoret me hollim në peshë – volum 0-max 10%). Hollimi i tepërt i përzierjes dëmton performancën finale të finiturës CONTINUO TOP ART.

Finiturat CONTINUO TOP ART komp A janë formuluar që të mund të përdoret i njëjti katalit CONTINUO TOP komp B.

Përgatitja e përzierjes: homogjenizoni duke e përzier manualisht CONTINUO TOP ART komp A nga sedimentet e mundshme.

Hidhni CONTINUO TOP komp B në përkatësin CONTINUO TOP ART komp A, përziejeni manualisht për rreth 45-60 sekonda. Është e mundur përzierja me trapan me helikë me xhiro të ngadalta për maksimalisht 1 minutë.

Jetëgjatësia e përzierjes: rreth 60 minuta. Më tej kësaj kohe produkti nuk duhet të përdoret, mos ndërhyri në rritjen e viskozitetit duke i shtuar akoma më shumë ujë.

Aplikimi: Për të përftuar një rezultat optimal, përta i përket homogjenitetit të sipërfaqes dhe uniformitetit të tharjes, shmangni aplikimin nën dritën e drejtpërdrejtë të diellit, në prani të sipërfaqeve të mëdha të xhamit, për të mbrojtur xhamin/dritaret, këshillohet shmangia e rrezeve të drejtpërdrejta të diellit. Në aplikimet, ku duhet të garantohet performanca maksimale përta i përket rezistencës ndaj ujit (shembull kutia e dushit) është mirë, që pas hollimit të përshtatshëm të aplikohet shtresa e parë e CONTINUO TOP ART duke përdorur ekskluzivisht pinelin.

Aplikimi me pinel ushtron një aksion mekanik më të madh, duke ndihmuar penetrimin dhe saturimin e mikroporeve të pranishme në sipërfaqe.

Në fazën e aplikimit të CONTINUO TOP ART, me qëllim shmangien e formimit të linjave jo estetike shumë të theksuara që vijnë si pasojë e kalimit të rrullit të leshit është i këshillueshëm aplikimi i produktit, në mënyrë që të mos krijohen vija gjeometrike (lart – poshtë- djathtas – majtas) (imazhi 2) preferohet realizimi i rrotullimeve jo-homogjene që ndjekin estetikën e spatulimeve, duke integruar në këtë mënyrë estetikën finale të dekorimit. (Imazhi 1)

Mbrojtja finale mund të modulohet në varësi të funksionit dhe estetikës, falë përdorimit të një prej 2 gjendjeve të shkëlqimit të finiturës. Përdorimi i llaqeve CONTINUO TOP ART, garanton arritjen e performancës teknike maksimale, pa penalizuar përsosjen estetike të sistemit.

Rezistenca e lartë kimike dhe mekanike, e bëjnë të përshtatshëm për përdorime shtëpiake dhe komerciale.



Në rastin e finiturave të realizuara me CONTINUO TOP ART efekt MATT ku dëshirohet garantimi maksimal i rezistencës ndaj substancave likuide, këshillohet aplikimi i një shtrese CONTINUO TOP ART SATIN mbi astarin, dhe përfundojeni me një shtresë CONTINUO TOP ART MATT.

6.2 PRODUKTE PLOTËSUESE

PRO LINK

Përgatitja e produktit: Homogjenizoni manualisht produktin para përdorimit.

- Mjetet: pinel, rrul.

- Përziени produktin para aplikimit.

- Hollimi: gati për përdorim ose max 10% me ujë.

- Nr. I shtresave: 1 shtresë.

- Pastrimi i mjeteve bëhet menjëherë me ujë, pas përdorimit.

- Shkalla e mbulimit: 15-20 m²/l. Duke pasur parasysh llojin e sipërfaqes është mirë të bëhet një provë praktike në sipërfaqe specifike për të përcaktuar konsumin.

ATOMO

Përgatitja e produktit: holloni produktin me ujë të pastër. Hollimi varion në funksion të llojit të sipërfaqes për t'u trajtuar.

- Mjetet: pinel, rrul.

- Përziени produktin para aplikimit.

- Hollimi: nga 50 deri në 100% me ujë.

- Nr. i shtresave: 1 shtresë.


- Pastrimi i mjeteve bëhet menjëherë me ujë, pas përdorimit.

- Shkalla e mbulimit: 15-18 m²/l.

Rrjetë në fibra xhami anti alkale

>70 < 90 gr/m² me gjerësi rrjete midis 3,5 mm dhe 4,5 mm.

Mënyra e aplikimit të rrjetës: mbështesni shiritin e parë të rrjetës, përsërisni operacionin duke bashkuar 2 shiritat e rrjetës, duke treguar kujdes që të mos i mbivendosni, për të shmangur pamjen e linjave jo-estetike, që mund të duken edhe pas një kohe të gjatë. Mbuloni të gjithë sipërfaqen duke treguar kujdes që të integroni mungesat, me qëllim shmangien e shkëputjes së sistemit ose pamjen jo-estetike, edhe pas disa kohësh nga aplikimi.



7_ SHKALLËT E MBULIMIT

Shkallët e deklaruara janë për orientim dhe mund të variojnë në varësi të gjendjes së sipërfaqes dhe llojit të kantierit. Për sipërfaqe shumë të mëdha, është mirë të verifikohet rrezja efektive me një provë paraprake në sipërfaqe specifike.

- **CONTINUO LEVEL_ZERO: (referuar pluhurit):** 7-8 kg/m² për spesor 5 mm, rreth 4 m² për thes për spesor 5 mm.
- **CONTINUO BASE: (referuar pluhurit):** 1,5-2,2 kg/m², në dy shtresa, në bazë të llojit të ndërhyrjes dhe gjendjes së sipërfaqes, rreth 7 - 8 m² për thes për 2 shtresa.
- **CONTINUO EPOXY COMBO:** 2,0-2,5 kg/m² në 2 shtresa, përzier në mënyrë të përshtatshme me CONTINUO BASE dhe i holluar, rreth 6 - 7 m² për thes për 2 shtresa.
- **CONTINUO DECO:** 1,2-1,5 kg/m² në dy shtresa, në bazë të llojit të ndërhyrjes dhe gjendjes së sipërfaqes. Për çdo shtresë shtesë, konsideroni një përdorim prej 0,300 gr/ 0,400 gr/m² rreth 15 m² për thes për 2 shtresa.
- **CONTINUO LINK:** 60-70 m² për shtresë, me një paketim të përzier dhe të holluar në mënyrë të përshtatshme (A+B).
- **CONTINUO LINK ART:** 35-40m² për shtresë, me një paketim të përzier dhe holluar përshtatshmërisht (A+B).
- **CONTINUO TOP:** 7-8 m²/l në dy shtresa, rreth 25 m² për paketim A+B për 2 shtresa.
- **CONTINUO TOP ART:** 7-8m²/l në dy shtresa ,rreth 25 m² për paketim A+B për 2 shtresa.

8_ SPECIFIKIME TEKNIKE DHE LIMITE PËRDORIMI

8.1 SIPËRFAQJA

Sipërfaqja duhet të jetë e ekzaminuar dhe përgatitur mirë. Duke pasur parasysh mundësinë e gjerë të ndërhyrjes me sistemet CONTINUO në tipe të ndryshme sipërfaqesh, në varësi të natyrës dhe karakteristikave të veta, vazhdoni me vlerësim të kujdesshëm para ndërhyrjes.



Sipërfaqet dhe nënshtresat e realizuara në pllaka dysHEMEJE, hapësira me ajrosje, duhet të izoloohen nga plani i tyre i mbështetjes me një hidroizolim efektiv dhe me një barrierë avujsh, që lejon aplikimin e produkteve të sistemit CONTINUO.

Verifikoni gjithmonë temperaturën e sipërfaqes, me qëllim garantimin korrekt të ngurtësimit të produkteve.

Vëmendje: Temperatura e ajrit nuk është një parametër me kuptim të mjaftueshëm.

Temperatura e sipërfaqes nuk duhet të rezultojë asnjëherë më e ulët se +8 °C. Në afërsi të temperaturës minimale ose me prani të lartë të lagështirës relative të ajrit, këshillohet ajrosja e ambienteve, me qëllim përmirësimin e tharjes së produkteve.

Në rast të dyshimeve mbi lagështirën prezente në sipërfaqe, në momentin e aplikimit, realizoni një verifikim instrumental me igrometër.



Mund të jetë i mjaftueshëm përdorimi i igrometrit me matje përmes sondës për kontakt; në rast ndërhyrjesh në beton, të bëra së fundmi dhe për punë në sipërfaqe të mëdha, matja direkte në material (për shembull igrometër karburi) rezulton më e besueshme.

Në mungesë të instrumentave të përshtatshme, është i mundur realizimi i një prove për të vlerësuar nëse sipërfaqja është në kushtet e lagështirës korrekte për realizimin e një prej sistemeve CONTINUO. Vazhdoni me aplikimin e një flete polietileni transparente në sipërfaqe, duke qenë të kujdesshëm që të mbulohet të paktën 1 m². Ngjisni përgjatë perimetrit me ngjitëse dhe kontrolloni pas 24 orësh fenomenet.

8.2 SIPËRFAQE BETONI (CLS)

Normalisht betoni (CLS) është i përbërë nga një hedhje uniforme në beton të përforcuar me rretë, të bashkuar me elektrodë që parandalon formimin e çarjeve. Kontrolloni dyshtemenë e betonit (CLS), duhet të jetë e izoluar me hidroziolim efikas dhe e qëndrueshme dhe me një barrierë avujsh, në mënyrë që të parandalohet ngjitja e ujit kapilar.


Sipërfaqet me dimensione të mëdha dhe dyshtemetë në beton përgjithësisht nuk janë të vazhdueshme. Në realizimin e kësaj lloji sipërfaqeje, në momentin e aplikimit, realizohen nyje. Këto i përgjigjen rregullave permanente teknike, funksionale sipas tipologjisë së tyre. Nyjet ndahen në "Nyje statike" dhe "Nyje dinamike", për këtë arsye konsultohuni me këtë manual në pikën 8.7 Nyjet. Sipërfaqja nuk duhet të ketë yndyrna, vajra dhe substanca kimike agresive. Pastroni mirë nyjet ose çarjet me anë të spatulimit, zmerilimit ...etj.

8.3 SIPËRFAQE TË SHTRUARA NË QERAMIKË, GRES TË PORCELANIZUAR, MOZAIKË, TË NGJASHËM

Sipërfaqja duhet të jetë ekzaminuar mirë për të verifikuar, edhe nëpërmjet goditjeve/përplasjeve, gjendjen e aderimit të pllakave. Hiqni pjesët që nuk janë të aderuara.

Përdorni si urë aderimi produktin Pro Link, sipas sasisë së treguar në pikën 6.2 Produkte plotësuese. Është e mundur prishja e sipërfaqeve horizontale dhe vertikale, duke përdorur një sandër orbital të pajisur me një aspirator dhe me një timon diamanti (imazhi 4/5), derisa të shkëputet sipërfaqja. I kushtoni vëmendje të veçantë këndeve dhe pikave që janë të vështira për t'u arritur. Vazhdoni më pas me pastrimin e sipërfaqes së zmeriluar nëpërmjet aspirimit, duke shmangur depozitimin e pluhurit ose e grimcave që mund të veprojnë si agjentë për shkëputje.

Vazhdoni me aplikimin e një shtrese të urës së aderimit Pro Link, sipas sasisë së treguar në pikën 6.2 PRODUKTE PLOTËSUESE.



Imazhi 4



Imazhi 5

8.4 DYSHEME NË PRANI TË NGROHJES/ FTOHJES

Nuk ekziston një sistem unik me shkëlqim për impiantet në dysHEME, dallimi bëhet në varësi të llojit të ndërhyrjes (ndërtesë e re ose e ristrukturuar) dhe të llojit të sistemit të ngrohjes tradicional me lëngje ngrohës (inerci e lartë ose inerci e ulët) ose rrezatues elektrik, i ndërtuar nga një shtresë e përbërë nga rrjeta me fibra xhami që vepron si mbështetje për përçuesit termikë të karbonit, të lidhur me një shirit izolues termik, për të reduktuar dispersionin termik poshtë.



Në përgjithësi betoni në të cilin do të realizohet dekorimi me sistemin CONTINUO duhet të jetë solid dhe të paraqesë norma të mira, për të siguruar një cikël të ndezjes progresive të impiantit, në modalitet ngrohjeje për të verifikuar funksionalitetin e impiantit dhe stabilizuar sipërfaqen, për ta bërë atë të pershtatshme për realizimin e sistemit CONTINUO.

Betoni, para aplikimit të sistemit CONTINUO duhet të rezultojë gjithmonë i thatë, homogjen dhe kompakt, në perimetrin e sipërfaqeve duhet të jetë i pranishëm një rrip i kompresueshëm që lejon hapjen e betonit.

Ekzekutimi i saktë i betonit rrezatue, përveçse përcakton gjatësinë dhe eficiencën e pjesës teknologjike të impiantit, ndikon shumë në cilësinë estetike dhe kohëzgjatjen e ndërhyrjes dekorative.

Sistemet CONTINUO nuk janë të përshtatshëm për ndërhyrje në prani të ngrohjes së dysHEMEVE me sistem tradicional (lëng ngrohjeje) me spesor minimal të betonit, mbi elementët me shkëlqim më pak se 30 mm.

Sistemet CONTINUO nuk janë të përshtatshëm për ndërhyrje në prani të ngrohjes (riscaldamento) së rrezatuesit elektrik, me spesor minimal të betonit, mbi elementët rrezatues më të ulët se 20 mm.

8.5 BETONE TRADICIONALE

Sistemet CONTINUO janë të aplikueshëm në lloje të ndryshme betonësh tradicionalë.

- Beton në rërë dhe çimento ose në rërë dhe lidhës specifik për beton;
- Beton të gatshëm të parapaketuar;
- Beton autonivelues në rërë dhe çimento.

Para se të vazhdoni, sigurohuni që betoni të jetë në kushte të mira dhe uniformisht i sheshtë.

Në rastet e betonit shumë kompakt dhe pak absorbues, është e mundur gërvishtja e sipërfaqes me një monospatulim ose me sandër orbital, të pajisur me letër me granë 24/36.

Për betone me shumë pluhur, konsolidoni duke përdorur CONTINUO LINK epoksid bi-komponent të hollueshëm me ujë, transparent, me fuqi të lartë penetruese dhe konsoliduese, për ta përdorur para hollimit me ujë në 200% në peshë.

Vazhdoni me pastrimin e të gjithë sipërfaqes së dekoruar nëpërmjet aspirimit, duke shmangur depozitimin e pluhurit ose të pjesëve që mund të veprojnë si shkëputës.

8.6 RRAFSHËSIA

Për një aplikim të suksesshëm, është e rëndësishme të punohet në sipërfaqe me rrafshësi të mirë. Sipërfaqja duhet të jetë e ekzaminuar mirë për të verifikuar, edhe nëpërmjet goditjeve, gjendjen e aderimit të gurëve/ pllakave. Hiqni pjesët e pa aderuara.

Verifikoni, me mastar (staggia), rrafshësinë e sipërfaqes. Në praninë e difekteve të rrafshësisë dhe disnivelit midis gurëve/ pllakave afër njëri-tjetrit, këshillohet të hiqni mekanikisht pjesët e prishura me sandër orbital, të pajisur me një disk diamanti dhe me një aspirator (Imazhi 4/5), derisa të hiqni shtresën sipërfaqësore. I kushtoni vëmendje të veçantë këndeve dhe pikave të vështira për tu arritur. Vazhdoni më pas me pastrimin e sipërfaqes së prishur nëpërmjet aspirimit, duke shmangur depozitimin e pluhurit ose pjesëve që mund të veprojnë si shkëputës.

Aty ku lind nevoja mund të ndërhyhet dhe të sistemohet me llaç autonivelues me bazë çimento. Në prani të rrafshësive të mëdha përsa i përket planit të referimit, do të duhet të gjenden zgjidhje të tjera në gjendje për të stabilizuar rrafshësinë brenda tolerancave normale të kantierit.

8.7 NYJET

Sipërfaqet me dimensione të mëdha dhe dyshemetë e betonit përgjithësisht nuk janë të vazhdueshme. Në realizimin e kësaj lloj sipërfaqeje, në momentin e aplikimit, realizohen nyjet/bashkimet. Këto u përgjigjen rregullave të thjeshta teknike, funksionale të tipologjisë së tyre. Nyjet ndahen në “Nyje statike” dhe “Nyje dinamike”. Nyjet statike, të realizuara menjëherë pas momentit të aplikimit të betonit nëpërmjet një prerjeje mekanike prej 1 cm thellësi, mund të mbuloen. Kanë funksionin e shmangies së tensionit gjatë fazës së vendosjes dhe ngurtësimit dhe janë lehtësisht të dallueshme në sajë të rrjetit tipik të shpërndarjes që krijojnë në sipërfaqe betoni me një gjatësi nga 3 deri në 5 m. Pasi mbaron faza e ngurtësimit, normalisht jo më pak se 12 muaj, humbasin funksionimin e tyre teknik dhe mundet që, aty ku kërkohet, të mbyllën.

Nga këndvështrimi funksional, nyjet dinamike duhet të mbeten të lira në thithjen eventuale të lëvizjes strukturore, ato kurrë nuk duhet të bashkohen ose të mbuloen.

Nuk mund të mbuloen nyjet e ndërtimit, të dizenuara për të kufizuar aktrimet e ndryshme, në raste të tilla, kaq të thella sa i gjithë spesori i dyshemesë. Është e mundur të parashikohet mbyllja e tyre me sisteme metalike ose fletë llamarine.

8.8 KUTIA E DUSHIT

Sistemet CONTINUO ACTIVITY, LOUNGE, mund të aplikohen edhe brenda në KUTI-në E Dushit. Para se të vazhdoni me aplikimin, verifikoni praninë dhe integritetin e hidroizolimit të sipërfaqes, mureve dhe dyshemesë. Në mungesë të integritetit, përgatitni sipërfaqen me produktet e përshtatshme hidroizoluese, duke ndjekur procedurat normale për aplikimin e qeramikës, materialit gur ose të ngjashëm.

Sigurohuni për praninë dhe gjendjen e hidroizolimit pranë piletave të dushit dhe dushit.

Para ndërhyrjes me sistemet CONTINUO ACTIVITY, LOUNGE, i kushtoni vëmendje përgatitjes së sipërfaqeve të lidhjes dysheme-mur dhe korrespondentëve me shkarkuesit.

Para realizimit të planit, verifikoni që të ketë pjerrësi të përshtatshme për kullimin e ujit, ndërhyrja me sistemin CONTINUO nuk duhet të dëmtojë pjerrësinë ekzistuese, me qëllim garantimin e shkarkimit të ujit.

Pas dekorimit të realizuar me CONTINUO DECO, i kushtoni vëmendje aplikimit të CONTINUO LINK ART duke përdorur një pinel, duke u siguruar që të ngopet e gjithë sipërfaqja dhe të gjitha zonat e lidhjes dysHEME-mur.



Në rastin e finiturave të realizuara me CONTINUO TOP ART efekti MATT ku kërkohet të garantohet rezistenca maksimale ndaj substancave likuide aplikohet, mbi astar, një shtresë CONTINUO TOP ART SATIN dhe përfundoheni me një shtresë CONTINUO TOP ART MATT.

Mbrojtja finale me një nga finiturat CONTINUO TOP ART është në gjendje të garantojë mbrojtje efikase.

Pas hollimit të përshtatshëm, aplikoni shtresën e parë të CONTINUO TOP ART duke përdorur ekskluzivisht pinelin.

Për ndërhyrjen në këtë kontekst, këshillohet aplikimi i një tjetër shtrese të finiturave CONTINUO TOP ART.

Pasi arrihet tharja, ngjisni me ngjithës specifik në korrespondencë me rrjetin e kullimit të dyshemesë.



Kontrollet përfundimtare të ndërhyrjes: pas të paktën 24 orësh nga ndërhyrja totale, është i këshillueshëm një test i mbajtjes së ujit. Lani të gjithë sipërfaqen e dekoruar duke përdorur kokën e dushit, duke përdorur ujë në temperaturë ambienti dhe e lini të grumbullohet për 30 minuta. Prezenca e mundshme e ndonjë çarjeje të vogël (intensiteti i pranisë së mikro-çarjeve nuk mund të jetë i tillë që të dëmtojë estetikën ose mundësinë e përdorimit të sipërfaqeve) mund të rregullohet duke rikaluar në zonën me interes, duke përdorur një pinel, astarin CONTINUO LINK ART me hollim siç është shpjeguar në pikën 6 PËRGATITJA E PRODUKTEVE.

8.9 RRËSHQITSHMËRIA E SIPËRFAQEVE

Rezistenca ndaj rrëshqitjes është një nga kushtet e nevojshme për ndërhyrjet në ambientet tregtare, meqë si sipërfaqe e rrëshqitshme konsiderohet një barrierë arkitektonike në gjendje të vështirësuar ecjen normale.

Për sistemet dekorative të realizuara në vend, si në rastin e sistemeve dekorative CONTINUO ose për dyshemetë me rezinë, për momentin nuk ekziston një normë specifike referimi që i referohet botës së dyshemeve.

Matja e koeficientit të fërkimit ose rezistenca ndaj rrëshqitjes në epokën e BE dhe në vendet e zhvilluara, nuk është trajtuar në mënyrë homogjene, krijon një tablo krejt të ndryshme që është unike me rezultatin e metodave të shumta të provës, edhe shumë të ndryshme midis tyre, jo direkt të krahasueshme. Midis metodave të provave të rrëshqitjes, një nga më të përdorurat platforma e ecjes në këmbë (la rampa a piedi calzati), e përshkruar nga norma DIN 51130, ku rrëshqitja është matur dhe klasifikuar duke përdorur shkallën e indeksit R (shembull R9 – rezistencë e keqe ndaj rrëshqitjes – në grupin R13 - Rezistencë e lartë ndaj rrëshqitjes).

Për Italinë D.M 236 e 1989 stabilizon në mënyrë të përgjithshme, që një dysheme ka veti anti-rrëshqitje kur koeficienti i fërkimit/tkurrjes matet në dysheme:

- Për elemente rrëshqitës lëkure në dysheme të thara, $\mu > 0,40$
- Për elemente rrëshqitës gome në dysheme të njoma, $\mu > 0,40$

Për rezistencën ndaj rrëshqitjes së sistemit CONTINUO raportet e provës janë të disponueshme. Norma kryesore referimi për lëmimin/rrëshqitjen:

- Prova sipas BCRA (D.M. 236/89): përcaktimi i koeficientit të tkurrjes mesatare (μ) në kushte: lesh në të thatë – gomë në të njomë.
- BS 7976-2:2002: "Pendulum Testers. Part 1: Specification". PTV në kushte të thatë dhe të njomë
- DIN 51130 (06/2004): "Testing of floor coverings. Determination of the anti-slip property - Workrooms and fields of activities with slip danger, walking method - Ramp test". Përcaktimi i këndit total të pranimit (vlera mesatare)
- EN 13036-4 (edizione ottobre 2011). Metodë për përcaktimin e aderimit sipërfaqësor të dyshemesë së rrugës dhe të aeroporteve, duke përdorur krahun e një lavjerrësi.
- UNI EN 14041:2018. Veshje elastike, tekstile, të laminuara dhe modulare me shumë shtresa për dysheme. Karakteristika esenciale
- BS 7976-2:2002: "Pendulum Testers. Determinazione dell'angolo medio di scivolamento; Part 1: Specification". PTV in condizioni di asciutto e bagnato
- DIN 51097 (92): "Testing of floor coverings. Determination of the anti-slip properties; wet-loaded barefoot areas; walking method; ramp test".
- ASTM C 1028-2007 E). Metoda e Testit Standard për Përcaktimin e Koeficientit Statik të Tkurrjes së Qeramikës (Standard Test Method for Determining the Static Coefficient of Friction of Ceramic "Tile and Other Like Surfaces by the Horizontal Dynamometer Pull-Meter Method").

Në rastin e kërkesave specifike që kanë të bëjnë me rrëshqitjen/lëmimin, është mirë të kontaktimi shërbimin teknik.

9_KUSHTET AMBIENTALE NË KANTIER

Sipërfaqet duhet të jenë të mbrojtura nga ngrirja dhe nga ndryshimet e forta termike përgjatë ciklit aplikativ. Mos aplikoni në temperaturë ajri, të sipërfaqes dhe të produktit, më të ulët se $+10^{\circ}\text{C}$ ose më të larta se $+35^{\circ}\text{C}$, as nën ndikimin e drejtpërdrejtë të diellit, as në sipërfaqe shumë të nxehta (edhe nëse janë në hije), as në sipërfaqe të njoma ose të lara.

Kushtet e ambientit dhe të sipërfaqes për të vazhduar me aplikimin, janë:

- Temperatura e ambientit: Min. $+10^{\circ}\text{C}$ / Max. $+35^{\circ}\text{C}$
- Lagështira relative e ambientit: $<75\%$
- Temperatura e sipërfaqes: Min. $+8^{\circ}\text{C}$ / Max. $+35^{\circ}\text{C}$
- Lagështira e sipërfaqes: $<4\%$

Aplikimi në kushte të ndryshme nga ato të përmendura më sipër, mund të shkaktojnë jouniformitete ose difekte në vetitë kimiko-fizike dhe në rezultatin estetik.

9.1 MAGAZINIMI I PRODUKTEVE



Mos i ekspozoni produktet CONTINUO për periudha të gjata me burime direkte të nxehtësisë ose temperatura më të ulëta se $+5^{\circ}\text{C}$. Në rastin e stokimit/magazinimit të produkteve në temperaturë afërsisht $+5^{\circ}\text{C}$ këshillohet dërgimi i tyre, para përdorimit, në një vend me temperaturë të përshtatshme, në mënyrë që të kushtëzohen në një temperaturë përdorimi jo më të ulët se $+10^{\circ}\text{C}$. Në rast të ruajtjes në temperaturë më të ulët se $+10^{\circ}\text{C}$, i kushtëzoni produktet duke i vendosur në një ambient të ngrohur saktësisht.

Mos përdorni burime direkte nxehtësie, flakë, trupa të nxehtë ose të ngjashëm.

Temperaturat e ulëta shtojnë viskozitetin në paketime, duke e bërë të vështirë përdorimin dhe zgjasin ose pengojnë procesin e tharjes dhe ngurtësimit të produkteve të ndryshme CONTINUO.

Temperatura maksimale e ruajtjes: +35 °C.

Stabiliteti në kovat/thasët origjinalë të pahapur dhe në kushte temperature të përshtatshme: 1 vit për produktet pluhur dhe bi-komponente, 2 vjet për produktet në pastë.

10_PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA E SIPËRFAQEVE

Pastrimi i sipërfaqes rutinë bëhet duke përdorur produkte pastrimi normale për dysheme. Mos përdorni agjentë shumë alkaline ose acidë, mund të dëmtojnë sipërfaqen e sistemit CONTINUO, duke komprometuar efektin estetik. Sipërfaqet kanë rezistencë të mirë ndaj një varieteti substancash me përdorim shtëpiak normal, në ambiente shtëpiake dhe profesionale. Është rregull i mirë, shmangia e kontaktit të zgjatur me substancat agresive. Pastrojeni menjëherë sipërfaqen CONTINUO me ujë.

Në ambiente shtëpiake, për pastrimin e sipërfaqeve mund të jenë të dobishme, zgjidhjet “bëje vetë” me bazë bikarbonat Natriumi dhe uthulle. Në sipërfaqe të përfunduara me llaqe transparente (dysheme në rezinë- parket- CONTINUO) nuk këshillohet përdorimi pasi përdorimi i dozave aksidentalisht të gabuara mund të rezultojnë korrozive dhe të dëmtojnë mbrojtjen e llakut. Duhet të shmangen kontaktet e zgjatura me lëng limoni, uthull, lëng domate, produkte antikalkare dhe detergjente acidë në përgjithësi.



Mos përdorni makina larëse dhe detergjente industriale, të destinuar për pastrimin e dyshemeve në qeramikë ose gurë, pasi mund të dëmtojë dhe modifikojë performancën dhe efektin estetik. Në përgjithësi sipërfaqet e veshura me sistemin CONTINUO mund të lahen me detergjente jo agresive (neutralë), me ujë të ftohtë ose pak të ngrohtë (mos e kaloni asnjëherë temperaturën e larjes prej 40°C, duke shmangur shok termikë dhe pastrimin me avuj).

Ndërhyrjet e mirëmbajtjes, sidomos nëse ndodhen në një pjesë të sipërfaqes, mund të jenë të dukshme. Normalisht këshillohet përdorimi i të njëjtës finiturë CONTINUO TOP OSE TOP ART të përdorur aplikimin fillestar. Aplikoni produktin me rrul me qime mesatare. Sipërfaqja do të jetë e kalueshme pas 24 orësh.



made in Italy



ERALDI
importim & aplikim

www.eraldi-shpk.com



Assistenza Tecnica
Numero Verde
800 853048
Colorimetria
Numero Verde
800 131611

San Marco Group SpA
Via Alta 10 - 30020 Marcon (VE) - Italy
T +39 041 4569322
F +39 041 5950153
info@san-marco .it export@san- marco.it
www.san-marco.com
www.decorativi.san-marco .com

AZIENDA CON SISTEMA
DI GESTIONE QUALITÀ
CERTIFICATO DA DNV GL
= ISO 9001 =



/sanmarcospa

